



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 05.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës 28.06.2024 të parashtuar nga Operatori Ekonomik **NOVUS SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Ritender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore”** me nr. prokurimi **206-24-1735-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **NOVUS SH.P.K.** e datës 28.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ritender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore”** me nr. prokurimi **206-24-1735-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 24.06.2024 të publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 24.06.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **NOVUS SH.P.K.** ka parashtuar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore”** me nr. prokurimi **206-24-1735-2-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 05.07.2024, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - AK nuk vlerëson ofertën e OE NOVUS në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me Dosjen e Tenderit, kjo pasi që OE në fjalë ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga AK, për çka oferta e të njëjtit duhet të konsiderohet si e përgjegjshme.

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - AK mund të anulohet/përfundojë aktivitetin e prokurimit në rast se: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; ka ndodhur ndonjë shkelje ligjore; apo kur një gjë e tillë është bërë e nevojshme, para hapjes së tenderëve, për shkak të ngjarjeve objektive jashtë kontrollit të AK.

Pretendimet ankimore - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE ankues:

Kjo Kërkesë për Rishqyrtim dorëzohet kundër Vendimit të datës 21.06.2024, përmes të cilit AK ka eliminuar OE NOVUS nga aktiviteti i prokurimit, dhe kundër Vendimit tjetër të datës 21.06.2023, përmes të cilit AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi me arsyetimin se nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.

AK ka eliminuar OE NOVUS me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kërkesat lidhur me dokumentacionin e kërkuar dhe kriteret për staf, si në vijim:

- Në pozitën d, është kërkuar që të jetë pozita me certifikata me VMware Horizon, ndërsa NOVUS ka dëshmuar z. Genc Jakupi, vetëm ka hyrë në test dhe se ka kaluar, dhe se nuk ka qenë e mundur të verifikohet se a është valide.

Në anën tjetër, OE NOVUS, sikurse vërtetohet nga dokumentet e dorëzuara, ka dëshmuar se lidhur me certifikimin e kandidatit në fjalë me certifikata në VMware Horizon, OE NOVUS ka dhënë sqarimet e plota dhe të nevojshme lidhur me mundsinë e verifikimit të kandidatit në fjalë i cili ka qenë në proces të pajisjes me certifikatat e kërkuara.

Sa i përket anulimit të aktivitetit të prokurimit, duhet të kemi parasysh faktin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të lejohet një gjë e tillë pasi që AK ka pranuar ofertë të përgjegjshme.

Në vijim, kemi paraqitur pretendimet tona ankimore lidhur me rastin në fjalë:

Pretendimi

ankimor

1:

OE NOVUS KA PARAOITUR OFERTË TË PËRGJEGJSHME

OE NOVUS ka paraqitur ofertë e cila i plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Një fakti i tillë dëshmohet nga dokumentet që OE në fjalë i ka dorëzuar me rastin e paraqitjes së ofertës.

Më konkretisht, për pozitën d, në kuadër të Dosjes së Tenderit kandidati i propozuar nga OE NOVUS, z. Genc Jakupi, ka përfunduar dhënien e provimit për marrjen e certifikatës VMware Horizon në Broadcom.

Trajnimi është i përfunduar si dhe të gjitha procedurat e tjera nëpër të cilat është dashur të kalohen. Megjithatë ky proces ka hasur në pengesa të tjera të cilat nuk kanë lidhje me NOVUS, tejkalimi i të cilave nuk varet nga vullneti i NOVUS. VMware është në periudhë të ndryshimeve të brendshme të ristrukturimit dhe e njëjta është në proces të kalimit në Broadcom, dhe kjo mund të dëshmohet në linkun e VMware portalit <https://vmware.my.site.com/partnerconnect/s/>.

Për shkak të ndryshimeve të brendshme të VMware, dëshmia për mbajtjen e trajnimit ka qenë e pamundur të migrohet në platformën e re e cila është në periudhë të ndryshimeve të brendshme të ristrukturimit dhe e njëjta është në proces të kalimit në Broadcom. OE NOVUS është ende në pritje të përgjigjes nga VMware për rregullimin dhe evitimin e këtyre pengesave. Sipas informatave të marra nga VMware, ky proces ka ngrirë platformën ekzistuese të VMware deri më datë 6 maj 2024, prandaj sistemi i ri është ende në përpilim nga ana e tyre. Deri në njoftimin e ardhshëm nga VMware, nuk mund të sigurohet certifikata mbi përfundimin e VMware Horizon por kjo nuk e anashkalon faktin që z. Genc Jakupi ka përfunduar të gjitha certifikimet që përfshijnë trajnimet e nevojshme të VMware dhe certifikata konsiderohet vetëm teknikalitet për të konfirmuar pikat që veçse janë dëshmuar nga OE Novus. Gjithashtu përfundimin e trajnimit mund ta vertetoni edhe me qendren trajnuese Semos Education. Gjithashtu edhe njëherë po ju paraqesim linkun e dëshmise për kalimin e provimit për certifikatën e VMware Horizon: [Linku: https://cp.certmetrics.com/vmware/en/public/transcript/36NLXBCK1FEQR9X](https://cp.certmetrics.com/vmware/en/public/transcript/36NLXBCK1FEQR9X) Gjithashtu dhe certifikatën e përfundimit të trajnimit të përfunduar.

Përveç kriterëve të përmbushura nga ana e stafit, OE NOVUS ka paraqitur edhe dëshmi të tjera, përkatësisht diploma të tjera, që dëshmojnë ekspertizën dhe përshtatshmërinë e tyre profesionale.

Pra, rezulton se nuk qëndron pretendimi i AK se OE NOVUS nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për përparësitë profesionale të kandidatëve për pozitën e përcaktuara sipas DT.

Në këtë drejtim, rezulton se oferta e OE NOVUS i plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga AK dhe, si e tillë, konsiderohet ofertë e përgjegjshme. Ofertat e përgjegjshme, ndërkaq, duhet të shpërblehen me kontratë.

Prandaj, rezulton se eliminimi i OE në fjalë nga aktiviteti i prokurimit si i papërgjegjshëm, nga ana e AK, rezulton se është bërë në mënyrë të kundërligjshme. Rrjedhimisht, Vendimi i AK për eliminim të OE NOVUS duhet të anulohet si i kundërligjshëm.

Pretendimi

ankimor

2:

NUK JANË PLOTËSUAR KUSHTET LIGJORE QË TË ANULOHEK AKTIVITETI I PROKURIMIT

Neni 62 i LPP-së shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundohet një aktivitet i prokurimit. Duke qenë se oferta e NOVUS është e përgjegjshme, nuk plotësohen kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Kjo përkundër se, siç kemi elaboruar edhe më sipër, OE NOVUS ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe ekonomikisht të favorshme - me çmim nën vlerën e parashikuar nga AK.

Në raste të tilla, kur dorëzohet një ofertë e përgjegjshme dhe e cila i plotëson të dy kriteret vendimtare për t'u shpërblyer me kontratë, AK nuk mund të përfundojë aktivitetin e prokurimit, por duhet ta shpërblejë me kontratë OE që dorëzon një ofertë të tillë.

Përfundimisht, bazuar në të lartcekurat, me respekt, kërkojmë nga AK që, pas shqyrtimit të kësaj Kërkese, të merr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur nga Operatori Ekonomik NOVUS SH.P.K..
- II. **ANULOHEK** Vendimi i Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, i datës 21.06.2024, për anulim të aktivitetit të prokurimit, dhe Letra Standarde për tenderuesin e eliminuar, e datës 21.06.2024, për eliminimin e OE NOVUS SH.P.K. nga ky aktivitet i prokurimit, dhe lënda kthehet në rishqyrtim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Sa i perket voneses ne kthimin e pergjigjes ne kerkesen tuaj per rishqyrtim, ju njoftojme se ne kemi qene duke e shqyrtuar kete kerkesë, por per shkak te rendesise se lendes kemi pasur konsultime edhe me profesionistet e lamise teknike dhe administrative, duke u munduar se nese ka mundesi ligjore per ti pranuar pretendimet e juaja ne kete ankese.

Pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara, duke marre parasysh se nuk i keni plotesuar te gjitha kriteret e kerkuara ne NJK dhe DT, andaj mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 24.06.2024 dhe arsyet per eliminim sipas Letres Standarde per tenderuesin e eliminuar.

Te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ne lidhje me stafin profesional te kerkuar, pika d, kriteri ka qene mjaft i qarte ku eshte kerkuar:

- d) **1 (një) VMware Horizon. Inxhinier i diplomuar në inxhinieri, Shkenca kompjuterike apo inxhinier i elektroteknikës**

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- d) **CV-në, Kopja e noterizuar e Çertifikatës VMware Horizon apo të dëshmohet me link. Kopjen e diplomës Universitare në inxhinieri Shkenca kompjuterike apo inxhinier i elektroteknikës si dhe kopjen e kontratës se punës apo para-kontratës per këtë projekt.**

Bazuar ne sqarimet e dhena nga ana juaj edhe pse te vonuara sa i perket afatit, gjate procesit te vleresimit te ofertave, si dhe ne kete kerkesë per rishqyrtim, ne si AK-MSh nuk e kundershtojme arsyetimin e juaj se z. Genc Jakupi sipas jush e ka perfunduar dhenien e provimit per VMware Horizon dhe profesionalizmin e ekspertit ne fjale, por anetaret profesional te komisionit vleresues mbeten te mendimit se nuk eshte plotesuar kriteri i kerkuar ne NJK dhe DT, meqense eshte kerkuar **Kopja e noterizuar e Çertifikatës VMware Horizon apo të dëshmohet me link**, e te cilen nuk e keni ofruar per z. **Genc Jakupi**.

d.m.th. edhe nese e ka kryer provimin dhe e ka nivelin e profesionalizmit, mungon **Kopja e noterizuar e Çertifikatës** si dokument i kerkuar per ta plotesuar kriterin.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit